

Because life matters most.

further



International  
Healthcare  
Programme



PROGRAMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR  
NDËRKOMBËTAR  
**UDHËZUESI**

DOKUMENT INFORMUES

## Përmbajtja

1	Mirë se vini në Programin e Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar .....	FAQJA 1
2	Çfarë mbulon Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar.....	FAQJA 2
3	Çfarë nuk mbulon Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar.....	FAQJA 4
4	Hartimi i një kërkesë sipas Programit të Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar .....	FAQJA 5
4.1	Zgjedhja e një spitali ndërkombëtar	
4.2	Përgatitja për trajtimin	
4.3	Gjatë kohës që merrni trajtimin jashtë shtetit	
4.4	Pas kthimit në shtetin tuaj të banimit	

## 1 Mirë se vini në Programin e Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Ky Program i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar është organizuar nga punëdhënësi juaj.

Ky udhëzues do t'ju shpjegojë përfitimet që gëzoni në kuadër të Programit të Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar. Ju gëzoni të drejtën për mbulimin gjatë kohës që jeni të punësuar nga INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A. dhe kur marrëdhënia juaj e punësimit është aktive. Bashkëngjitur me këtë udhëzues është një Planifikim për përfitimet, ku detajohen limitet për shumat e siguruara.

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar është një program për mbrojtjen e shëndetit që ju ofron si më poshtë:

- Akses për një opinion të dytë mjekësor nga një specialist;
- Mbulimin për shpenzimet mjekësore, të udhëtimit dhe të strehimit, si dhe përfitime të tjera kur merrni trajtime për sëmundje specifike të rënda në spitalet kryesore ndërkombëtare jashtë shtetit ku banoni;
- Rimbursimin e shpenzimeve mjekësore kur të ktheheni në atdhe.

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar nuk është një program që paguan një shumë të vetme "lump-sum" me identifikimin e diagnozës, por është një program që mbulon koston e trajtimit, duke përfshirë organizimin e udhëtimit dhe të strehimit, deri në shumën e siguruar dhe limitet individuale të përcaktuara në Planin e e Përfitimeve të Programit e siguruar dhe limitet individuale të përcaktuara në Planifikimin e përfitimeve.

Udhëzuesi i mëposhtëm paraqet një përmbledhje të mënyrës se si mund të keni akses për shërbimin e opinionit të dytë mjekësor dhe se si të bëni një kërkesë në kuadër të këtij programi.

Shërbimet në këtë program ofrohen në bashkëpunim me:

Best Doctors: kompania përgjegjëse për shërbimin e një opinionit të dytë, e njohur edhe si InterConsultation@.

Further Underwriting International, SLU (Further): kompanitë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit mjekësor dhe jo mjekësor në lidhje me organizimin e trajtimit jashtë shtetit.

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

## 2 Çfarë mbulon Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

### Shërbimi i opinionit të dytë mjekësor nga specialisti

Ju keni akses në shërbimin InterConsultation® të Best Doctors, i cili ju ofron akses në informacione dhe këshilla nga specialistët më të mirë ndërkombëtarë.

Programi Best Doctors, ka një bazë të dhënash të specialistëve ku përfshihen mbi 50 000 specialistë leader në të gjithë botën. Best Doctors përdor një metodologji për vlerësimin nga kolegët që bën të mundur krijimin e një rrjeti unik dhe të respektuar me specialistë që njihen në nivel ndërkombëtar si më të mirët në fushën e tyre.

Si pjesë e këtij shërbimi, Best Doctors do të mbledhë të dhënat tuaja mjekësore dhe testet diagnostikuese dhe do t'ia dërgojë specialistit të zgjedhur për një rishikim të plotë. Specialisti i zgjedhur do t'ju ofrojë një raport eksperti të qartë që rishikon dhe konfirmon diagnozën dhe planin tuaj të trajtimit. Gjatë të gjithë procesit, do të ndihmoheni nga një Menaxheri i posaçëm për çështjen tuaj "Case Manager". Këtë shërbim mund ta kërkonit në çdo kohë.

### Trajtimi jashtë shtetit

Ju mund të zgjidhni që të merrni një trajtim jashtë shtetit ku banoni, në kuadër të Sëmundjeve dhe procedurave mjekësore të mbuluara si më poshtë:

### **Trajtimi i kancerit**

Trajtimi për:

1. Çdo tumor malinj duke përfshirë leukeminë, sarkomën dhe limfomën (përveç limfomës së lëkurës) që karakterizohen nga një rritje dhe përhapje e pakontrolluar e qelizave malinje dhe ndërhyrje në inde;
2. Çdo kancer in-situ që është i kufizuar tek epiteli ku ka pasur origjinën dhe nuk është shtrirë te stroma ose indet rrethuese.
3. Çdo ndryshim para kancerit në qeliza që klasifikohen në kuadrin citologjik ose histologjik si displasi e nivelit të lartë ose displasi e rëndë.

### **Kirurgjia e bajpasit për arterien koronare**

Kryerja e kirurgjisë sipas këshillës së një kardiologu konsulent për të korigjuar ngushtimin ose bllokimin e një ose disa arterieve koronare me transplante bajpasi.

### **Zëvendësimi ose riparimi i valvulës së zemrës**

Ndërhyrje kirurgjikale sipas këshillës së një kardiologu konsulent për të zëvendësuar ose riparuar një ose disa valvula të zemrës.

Because life matters most.

**further**



FAQJA 2

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

## Neurokirurgjia

Do të thotë:

- Çdo ndërhyrje kirurgjikale në tru ose në struktura të tjera intrakraniale;
- Trajtimi i tumorëve beninjë që ndodhen në shtyllën kurrizore.

## Transplanti i organeve nga një dhurues i gjallë

Do të thotë një transplant kirurgjikal ku Anëtari i siguruar merr një veshkë, një pjesë të mëlçisë, një log pulmonar ose një pjesë të pankreasit nga një dhurues tjetër i gjallë dhe i përputhshëm.

## Transplanti i palcës së kockës

Do të thotë transplantimi i palcës së kockës (BMT) ose Transplantimi i qelizave staminale periferike të gjakut (PBSCT) për qelizat e palcës së kockës tek Anëtari i siguruar që e kanë origjinën nga:

- Anëtari i siguruar (transplanti autolog i palcës së kockës); ose
- Nga një dhurues i gjallë i përputhshëm (transplant alogjenik i palcës së kockës).

Ky Program do të paguajë për:

- Kostot dhe shërbimet e hospitalizimit, duke përfshirë kirurgjinë, vizitat ose konsultat me doktorin, analizat dhe testet mjekësore, transfuzionet, barnat (për një periudhë deri në 30 ditë pas daljes nga spitali jashtë shtetit dhe blerjen e tyre pas kthimit në shtetin e banimit), transfertat ose transportin ajror në rast se është e nevojshme në aspektin mjekësor;
- Shpenzimet për udhëtimin dhe strehimin për anëtarin e siguruar plus një shoqërues dhe një dhurues (në rast transplantit);
- Kostot e riatdhesimit për Anëtarin e siguruar dhe dhuruesin (në rast transplantit) në rast rast vdekje gjatë marrjes së trajtimit jashtë shtetit;
- Kostot e mjekimit (Përfitimi mjekësor) për vazhdimin e trajtimit pas kthimit në shtetin e banimit

Ky Program nuk do të paguajë për:

- Asnjë trajtim mjekësor në shtetin e banimit (me përjashtim të Përfitimit të mjekimit);
- Rimbursimin për barnat që nuk janë miratuar paraprakisht nga Further dhe kompania e sigurimit.

Because life matters most.

**further**



FAQJA 3

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

## 3 Çfarë nuk mbulon Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar?

### Shërbimi i opinionit të dytë mjekësor nga specialisti

Mund të merrni një opinion të dytë mjekësor nga Best Doctors edhe nëse gjendja juaj mjekësore nuk mbulohet sipas Paragrafit 2 "Trajtimi jashtë shtetit" specifikuar si më sipër; sidoqoftë shërbimi nuk ofrohet në lidhje me gjendjet e shëndetit mendor, gjendjet akute (kur simptomat shfaqen dhe ndryshojnë ose përkeqësohen me shpejtësi), sëmundje kronike të lehta, probleme dentare ose nëse jeni të shtruar në spital kur bëni kërkesën.

### Trajtimi jashtë shtetit

Ka disa gjendje, trajtime dhe shpenzime që nuk mbulohe. Disa prej tyre janë:

#### **Sëmundjet ose procedurat mjekësore të përjashtuara**

- Disa lloje të kancerit. Programi mbulon melanomat malinje që është forma më agresive dhe kërcënuese për jetën e kancerit të lëkurës, por format e tjera të kancerit të lëkurës janë të përjashtuara.
- Disa lloje të transplantëve (si ato që janë bërë të mundura nëpërmjet blerjes së organeve).

#### **Përjashtimet mjekësore**

- Sëmundjet e lidhura me AIDS ose që shfaqen kur një anëtar i siguruar është pozitiv me virusin HIV ose vuan nga AIDS;
- Trajtimet eksperimentale ose mjekësia alternative;
- Disa shërbimet të kujdesit mjekësor dhe kujdesi në një azil ose qendër qëndrimi;
- Kujdesi mjekësor për dementian ose humbjen e funksionit mendor.

#### **Shpenzimet e përjashtuara**

- Protezat (si p.sh. gjymtyrët artificiale ose sytë prej qelqi), përveçse për valvulat e zemrës si proteza dhe implantet e gjoksit pas një mastektomie;
- Pajisjet ortopedike, si p.sh. mbështetëse për qafën dhe shufra metalike mbështetëse;
- Blerja e karrocave me rrota, krevateve të veçanta ose çdo pajisje mjekësore;
- Kostoja e telefonatave.

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

## 4 Bërja e një kërkesë sipas Programit të Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

### Shërbimi i opinionit të dytë mjekësor nga specialisti

Për të kërkuar një opinion të dytë mjekësor ose për të bërë një kërkesë në kuadër të Programit, duhet të telefononi qendrën e shërbimit të klientit në numrin +355 4 2233308 ose të dërgoni një email në [ispclaim@wegofurther.com](mailto:ispclaim@wegofurther.com). Pasi të keni kontaktuar dhe të jetë miratuar kërkesa për shërbimin e opinionit të dytë mjekësor, ju do të merrni një paketë informuese. Kjo paketë informuese do të shpjegojë në detaje se çfarë përfshin shërbimi dhe cilat pjesë do të duhet të plotësoni, duke përfshirë nënshkrimin në formularët e duhur për autorizimin. Menaxheri i posaçëm i çështjes do t'ju ndihmojë dhe kërkesa juaj do të trajtohet në mënyrë konfidenciale.

Informacionet që do të kërkohen që të jepni do të përfshijnë emrat e spitaleve dhe doktorëve që keni vizituar, informacione për gjendjen tuaj mjekësore, si dhe anamnezën tuaj mjekësore. Do të jetë e nevojshme po ashtu që të jepni një pëlqim të nënshkruar (në disa raste do të kërkohet një prokurë) për kërkesën dhe aksesin të të dhënave tuaja mjekësore nga doktori ose ofruesit mjekësorë që ju trajtojnë.

Si opsion, ju mund t'i jepni drejtpërdrejt dokumentet tuaja mjekësore.

Pra, shkurtimisht, shërbimi i opinionit të dytë mjekësor do të kërkojë:

- Aplikimin e nënshkruar nga Anëtari i siguruar (ose përfaqësuesi ligjor) me miratimin për dhënien e të dhënave mjekësore nga doktorët që kryejnë trajtimin;
- Një kopje të dokumentit që identifikon Anëtarin e siguruar. Dokumentet e pranuar përfshijnë: Një pasaportë Një certifikatë lindje
- Të dhënat mjekësore/anamneza përkatëse për sëmundjet që po vlerësohet për rishikim bashkë me deklaratën mjekësore të lëshuar nga zyramjekësore përkatëse me diagnozën përfundimtare dhe përshkrimin e trajtimit të kryer (nëseka);
- Të gjitha kopjet përkatëse të rezultateve të kërkimeve laboratorike, klinike, histologjike dhe të tjera, të certifikuara nga zyra mjekësore që i lëshon.

Mund të kërkohen dokumente shtesë nga një këndvështrim mjekësor, sipas nevojës.

Pas marrjes së të dhënave mjekësore, rasti juaj do t'i kalohet një specialisti ndërkombëtar të zgjedhur si "më i miri" nga doktorët e tjerë, për të trajtuar pyetjet tuaja.

Specialisti ndërkombëtar do të ofrojë një raport specialisti që do të përfshijë një vlerësim të diagnozës tuaj si dhe një përgjigje për pyetjet tuaja. Ky raport do të dorëzohet bashkë me një përkthim në gjuhën tuaj lokale.

Në varësi të rrethanave mjekësore të rastit, mund të jepet asistencë në dorëzimin e raportit për doktorin tuaj, në mënyrë që rezultatet e raportit të specialistit të mund të merren parasysh në planin e trajtimit tuaj.

Because life matters most.

further



FAQJA 4

Because life matters most.

further



FAQJA 5

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

## Trajtimi jashtë shtetit

Nëse kërkesa juaj është që të merrni një trajtim për një Sëmundje ose procedurë mjekësore të mbuluar, do t'ju kërkohet të ndiqni të njëjtën procedurë siç shpjegohet më sipër kur kërkonit një opinion të dytë mjekësor. Nuk është e nevojshme të kërkonit një opinion të dytë mjekësor kur konsideroni një trajtim jashtë shtetit, por të dhënat tuaja mjekësore do të duhet të mblidhen ose të jepen përsëri për të konfirmuar që kërkesa juaj është e pranueshme.

Nëse kërkesa juaj është e vlefshme dhe gjendja juaj mbulohet nga Programi, agjencia Further do t'ju kërkojë të konfirmoni nëse dëshironi opsionin e marrjes së trajtimit jashtë shtetit.

## Opsionet e klinikave jashtë shtetit

Në rast se zgjidhni që të merrni një trajtim jashtë shtetit, agjencia Further do t'ju ofrojë një listë të spitaleve më të mira ndërkombëtare.

Zakonisht lista do të përfshijë minimumi 3 spitale, por në varësi të natyrës mjekësore të rastiit, mund të rekomandohet më specifikuisht një spital i veçantë.

Më pas do t'ju kërkohet t'i konfirmoni Further-së zgjedhjen e një prej këtyre spitaleve brenda 3 muajve në vijim. Këtë do të duhet ta bëni duke plotësuar formularin përkatëse që do t'ju jepet nga agjencia Further. Ju duhet të përcaktoni po ashtu se cili do të jetë shoqëruesi juaj.

Nëse Further nuk merr një përgjigje brenda 3 muajve, mund të jetë e nevojshme të rivlerësohet statusi i gjendjes tuaj mjekësore dhe t'ju paraqitet një listë e përditësuar e spitaleve.

Ka disa pika që duhet të keni parasysh në lidhje me trajtimin jashtë shtetit:

- Ndikimi financiar i marrjes së trajtimit jashtë shtetit, bazuar në koston e jetesës në shtetin e destinacionit, koston e shpenzimeve që nuk mbulohe nga ky Program (p.sh. shpenzimet për ushqimet gjatë trajtimit ambulator, përveç mëngjesit, për ju dhe shoqëruesin tuaj) dhe kohëzgjatja e parashikuar për trajtimin;
- Disa nga shpenzimet që nuk mbulohe mund të paguhen duke përdorur përfitimin e Dëmshpërblimit ditor të hospitalizimit që ofrohet nga Programi; Aspektet psikologjike të të qenit larg nga shtëpia ose nga anetarët e familjes dhe diferencat kulturore dhe gjuhësore me vendin tuaj të lindjes ose shtetin e banimit;
- Duhet të keni një pasaportë të vlefshme dhe të jeni në një pozitë të tillë për të marrë një VIZË për shtetin e destinacionit që po merrni në konsideratë.

Për aplikimin tuaj për VIZË, agjencia Further do t'ju ofrojë mbështetje dhe asistencë gjatë të gjithë procesit, duke përfshirë ofrimin e të gjitha dokumentacioneve përkatëse mjekësore që nevojiten për aplikimin dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të nevojshëm. Further, kur është e mundur, do të dorëzojë aplikimin tuaj për VIZË në emrin tuaj dhe do të ndjekë progresin e aplikimit. Programi do të paguajë për shpenzimet administrative të shkaktuara si rezultat i procesit të aplikimit për VIZË. Further nuk mund të garantojë që një aplikim për VIZË do të jetë i suksesshëm.

Because life matters most.

further



FAQJA 6

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Nëse është e nevojshme, Further do të sigurojë mbështetje për procesin e aplikimit për VIZË si dhe çdo shërbim tjetër ndihmës që kërkohet, si p.sh. caktimi i takimeve në konsullatën ose ambasadën përkatëse.

## Përgatitja për trajtimin

Pasi Further të ketë marrë konfirmimin nga ju për zgjedhjen e spitalit, do të pëcaktohen datat për udhëtimin dhe shtrimin në spital dhe do t'ju jepet një Certifikatë mjekësore paraprake.

Certifikata mjekësore paraprake është miratimi me shkrim për kërkesën që jepet nga Further. Kjo Certifikatë përfshin konfirmimin për mbulimin në këtë Program para kryerjes së shërbimeve në spitalin e përcaktuar, për çdo trajtim, shërbim, material ose rekomandim në lidhje me Kërkesën.

Duhet të merrni parasysh të pajiseni me policë sigurimi në udhëtim për të mbuluar rrethana të paparashikuara që nuk mbulohe nga ky Program.

Në lidhje me organizimet për hospitalizimin:

- Further do të organizojë ofrimin e të dhënave tuaja mjekësore për personelin mjekësor në spital;
- Further do të kujdeset që të shoqëroheni kur të shkoni për herë të parë në spital ose kur do të takoni doktorin që kryen trajtimin dhe do t'ju ndihmojë për përgatitjen e dokumentacionit për pranimin dhe organizimin e shtrimit në spital;
- Further do të paguajë koston e trajtimit mjekësor të mbuluar nga Programi drejtpërdrejt për spitalin.

Në lidhje me organizimet për udhëtimin:

- Further do të organizojë dhe do të paguajë transportin nga banimi i juaj i përhershëm, për ju dhe për shoqëruesin tuaj të udhëtimit (plus dhuruesin e gjallë në rast transplantit), për në aeroportin ose stacionin hekurudhor ndërkombëtar të përcaktuar, biletën e trenit ose avionit të kategorisë ekonomike për në qytetin e destinacionit të trajtimit dhe transportin për në hotelin e përcaktuar;
- Further do të ndihmojë për të njëjtat organizime për udhëtimin e kthimit pas përfundimit të trajtimit jashtë shtetit.

Në lidhje me organizimet për strehimin:

- Further do të organizojë dhe do të paguajë për strehimin tuaj dhe një shoqërues (plus dhuruesin e gjallë në rast transplantit) kur qëndroni jashtë shtetit për marrjen e trajtimit;
- Organizimi i strehimit do të përfshijë rezervimin për një dhomë dyshe ose dhomë me dy krevate teke në një hotel me 3 ose 4 yje (sipas standardeve ndërkombëtare) duke përfshirë shërbimin e mëngjesit;

Because life matters most.

further



FAQJA 7

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

- Further do t'ju ofrojë po ashtu një shërbim transporti vajtje-ardhje të përditshëm nga hoteli i përcaktuar për te spitali ose doktori i trajtimit tuaj. Ky shërbim transporti do të ndihmojë për vizitat tuaja te doktori në bazë ambulatorie ose vizitat e shoqëruesit tuaj në spitalin ku merrni trajtimin;
- Zgjedhja e hotelit do të jetë objekt i disponueshmërisë dhe bazuar në afërsinë me spitalin ose doktorin e trajtimit tuaj, brenda një rrezeje prej 10 kilometrash.

Mëngjesi do të përfshihet me strehimin tuaj në hotel, por sidoqoftë ushqimet dhe kostot e tjera si shërbimi i lavanterisë nuk mbulohen, por nëse gëzoni të drejtën për Shpërblimin ditor të hospitalizimit (shtrimin në spital, mund të përdorni këtë për të paguar për kosto të tilla.

Further do të bëjë një vlerësim të arsyeshëm për kohëzgjatjen e trajtimit tuaj bazuar në eksperiencën me raste të ngjashme dhe, mbi këtë bazë, Further do të kryejë organizimin për strehimin. Këto do të përshtaten, nëse është e nevojshme, sipas zhvillimit të trajtimit.

## Gjatë kohës që merrni trajtimin jashtë shtetit

Kur merrni trajtimin jashtë shtetit, ju do të vazhdoni të jeni në komunikim të drejtpërdrejtë me Further nëpërmjet Menaxherit të posacëm të çështjes.

Mund të kontaktoni me Further nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me zhvillimin e trajtimit ose çdo pyetje tjetër në lidhje me kërkesën tuaj.

Further do të mund të ofrojë po ashtu shërbime përkthimi mjekësor kur jeni në spital ose nën kujdesin e një specialisti mjekësor jashtë shtetit, nëse mendoni se keni nevojë për këtë shërbim.

## Pas kthimit në shtetin tuaj të banimit

Pas kthimit, Further do të sigurohet që të keni një raport të zgjeruar në lidhje me trajtimin tuaj jashtë shtetit dhe një plan të detajuar për vazhdimin e trajtimit tuaj në shtetin ku banoni. Further do t'i përkthejë këto për ju dhe do të diskutojë çdo hap gjatë vazhdimin të kujdesit në shtetin tuaj.

Mund të ketë rrethana që mund të kërkojnë që të udhëtoni përsëri jashtë shtetit për ndjekjen ose monitorimin e gjendjes dhe trajtimin tuaj me doktorin ndërkombëtar, dhe Further do të kujdeset për organizimin e kësaj po ashtu. Këto organizime dhe kosto mbulohen po ashtu nga ky Program (kur jeni akoma një anëtar aktiv i siguruar).

Pas trajtimit jashtë shtetit, Further do të propozojë një plan mjekimi për vazhdimin e trajtimit. Në këtë Program ka një Përfitim për mjekimin që është hartuar posaçërisht për të mbuluar shpenzimet për blerjen e barnave të tilla. Që ky përfitim të mund të paguhet në kuadër të Programit, duhet të arrini të merrni rekomandime për mjekimin nga doktorët që ju trajtojnë në shtetin ku banoni.

# Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Further do të diskutojë me ju për detajet e Përfitimit të mjekimit para se të ktheheni në shtetin e banimit që të mund të jeni të ndërgjegjshëm për pengesat dhe kufizimet.

Pasi të keni nisur një Plan mjekimi pas kthimit në shtetin tuaj të banimit, ju do të rimbursoheni për shpenzimet që do të ndodhin sipas këtij plani.

Further do t'ju ofrojë një formular rimbursimi që ta dorëzoni me faturat dhe rekomandimet përkatëse për barnat e blera. Më pas Further do t'ju rimbursojë drejtpërdrejtë logarinë tuaj për shumën e caktuar brenda një periudhe prej 10 ditë pune.

## Planifikimi për përfitim

<b>Limiti i shumës së siguruar për anëtar të siguar/vit të politikës</b>	<b>500 000 euro</b>
<b>Limiti total për të gjithë kohëzgjatjen për anëtar të siguruar</b>	<b>1 000 000 euro</b>
<b>Shpenzimet mjekësore</b>	<b>50 000 euro gjatë kohëzgjatjes së politikës</b>
<b>Dëmshpërblimi ditor për hospitalizimin (shtrimin në spital)</b>	<b>100 euro të kufizuara për 60 ditë për kërkesë</b>
<b>Udhëtimi dhe strehimi</b>	<b>Shpenzimet janë të përfshira në limitet vjetore dhe për të gjithë kohëzgjatjen për shumën totale të siguruar</b>

Because life matters most.

**further**



Because life matters most.

**further**



Because life matters most.  
**further**



**International  
Healthcare  
Programme**

[www.internationalhealthcareprogramme.com](http://www.internationalhealthcareprogramme.com)